

“Banka e të akuzuarit për avokatin: Drejtësia shqiptare në fillimet e represionit komunist”

Që në ditët e para të sundimit të tyre, komunistët shqiptaë u kujdesën që edhe “drejtësia” e tyre të kishte karakter revolucionar. Mbështetur në një politikë repressive dhe në parimin e “diktaturës së proletariatit”, Gjykata Speciale dhe Gjykatat Ushtarake, pa i dhënë rëndësi procedurës dhe fakteve, gjatë viteve 1945-1948, dënoi shumë persona. Të parët që iu nënshtruan dënimeve të ashpra ishin zyrtarët e të gjitha niveleve të administratës shtetërore që kishin shërbyer përpara ardhjes në pushtet të komunistëve.

Në proceset e para gjyqësore të natyrës represive, një pjesë e të akuzuarve ishte dhe shtresa e avokatëve të cilët ishin shkolluar në perëndim. Tre prej tyre të cilët janë dënuar në procese të ndryshme gjyqësore të viteve 1945-1949 ishin: Qenan Abdurrahman Dibra, Terenc Toci dhe Baltazar Benusi.

Gjyqi ndaj “Bashkimit Demokrat.”

Ndonëse rezistenca kundër pushtuesve dhe fitorja ndaj tyre u kishte dhënë komunistëve mjaft kredite popullariteti dhe lehtësoi mjaft ngritjen e tyre në pushtet që gjatë Luftës së Dytë Botërore, paqja po rezultonte e vështirë për t’u menaxhuar. Në dt.17 Tetor 1945, pikërisht në prag të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, u zhvillua Plenumi IV i KQ të PKSH-së, i cili analizoi situatën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. Pjesëmarrësit në mbledhje u shprehën të shqetësuar mbi mbështetjen e masave ndaj rregjimit të ri. Enver Hoxha në referatin e tij “*Mbi situatën e brendshme dhe të jashtme*” theksonte se “*reaksioni jonë nuk i kishte rrënjët në ujë*”. Sipas tij, situatë ndërkombëtare kiste nxitur “reaksinonin” për t’u organizuar dhe për të krijuar një lëvizje opozitare. Ai konsideronte si opozitarë të mundshëm popullsinë e veriut të Shqipërisë, e cila ishte terësisht nën influencën e krerëve fisnorë; elementët e pakënaqur nga rreformat e ndërmara nga Qeveria Provizore Demokratike; klerin katolik; “*shtresat e intelektualëve të pasqaruar dhe që kanë qënë ose janë në pozitë e armikut, ose në indiferencë, shtresat e tregtarëve të mëdhenj, që i kanë goditur tatimet e fitimeve të jashtëzakonshme, spekulatorët e përhershëm, shtresat e bejlerëve dhe të agallarëve që i ka prekur ligji i Rreformës Agrare dhe rreth këtyre me siguri mund të grumbullohen në rast se ne nuk punojmë drejt dhe nuk zbatojmë si duhet vijën e Frontit, të gjithë ata elementa indiferentë të papërzier me politikë dhe që nuk arrijnë të kuptojnë si duhet manovrën e reaksionit dhe përpjekjet tona në këtë situatë të vështirë.*”¹

Një prej proceseve gjyqësore me natyrë repressive të rregjimit komunist ishte edhe gjyqi nga grupimit: “Bashkimi Demokratik”, ku është dënuar avokati Qenan Abdurrahman Dibra.

Kush ishte Qenan Abdurrahman Dibra?

QENAN DIBRA

¹ AQSH, F.14/AP ORG.UDH.V.1945, D.2, FL.8-10



Emër/Mbiemër	Qenan Dibra
Atësia	Abdurrahman
Vendbanimi	Tiranë
Datëlindja	1912
Profesioni/Edukimi	Avokat/Universiteti i Drejtësisë, Paris, Francë
Dita e vdekjes	3.07.1946
Dita e Arrestimit	10.01.1946
Akuza	<i>“Sabotator i Pushtetit dhe armik i Popullit, pjestar dhe organizues i grupit monarkist kundra Pushtetit në lidhje dhe me grupe të tjerë.”</i>
Lloji i ekzekutimit	Me pushkatim
Fondi arkivor	Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081

(Dibër 1912 - Tiranë 3 Korrik 1946)

Lindur në Dibër 1916, djali i Abdurrahmanit, deputet dhe Ministër gjatë Monarkisë. Kreu Liceun Francez në Korçë, diplomuar në Paris për jurisprudencë, në Fakultetin e Drejtësisë. Prej afro një viti punon në Ministrinë e Punëve të Jashtme. U dënua me vdekje, pushkatim më 3 Korrik 1946 në gjyqin special kundër partisë “Bashkimi Demokratik Shqiptar” si kreu i Organizatës Kombëtare Monarkiste, që u bë pjesë e grupimit opozitar që kërkoi përmes një Memorandumi shtyrjen e zgjedhjeve që u zhvilluan më 2 Dhjetorit 1945.

Një nga anëtarët e Komitetit të Përbashkët nga Grupit Monarkist që u bë pjesë e tri korentëve opozitare të Partisë Bashkimi Demokratik Shqiptar krijuar si shkrirje e tri grupimeve atij të Legalitetit (përfaqësuar nga Qenan Dibra), i rezistencës (kryesuar Sami Qeribashi) dhe atij socialdemokrat (kryesuar nga Musine Kokalari).

Hartoi bashkë me shkrimtaren e njohur Musine Kokalari, Programin e Opozitës. Anëtar i dërgatës që i dorëzoi memorandumit Nën/Kolonelit Palmer në Misionin Ushtarak Britanik. Në notën e dorëzuar shprehej kërkesa pranë fuqive aleate për ndërhyrje të misioneve anglo-amerikane pranë Qeverisë së Tiranës për garantimin e zgjedhjeve të lira demokratike dhe monitorimin nga anglo-amerikanët të këtyre zgjedhjeve dhe shtyrjen e tyre.

Hetimi dhe gjykimi i Qenan Abdurrahman Dibrës.

Në dosjen 1081.A 1, fq.203-219 gjendet vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake i dt.2.Korrik 1946 që e dënonte Qenan Dibrën me vdekje.

“Qenan Dibra, i biri i Abdurrahmanit dhe Adiles, lindur në Dibër në 1912 dhe banues në Tiranë, me profesion avokat, ka mbaruar Universitetin e Drejtësisë në Francë. Element kryesor i grupit. Ka qënë në të gjitha mbledhjet që janë bërë kundra rregjimit të sotshëm në bashkëpunim me Kiço Xhongën dhe me Palmerin (Englez). U dënue me vdekje nga Gjyqi Ushtarak më datën 3.7.1946 dhe u ekzekutue.”²

Në fq.277 të dosjes arkivore gjendet vendimi *“Mbi ekzekutimin dhe vullnetin e fundit të të dënuarve”* ku Qenan Dibra ishte shprehur me fjalët: *“Rroftë Shqipëria me Kosovën.”*³

Ky procesverbal është mbajtur nga Prokurori i Gjykatës së Lartë Ushtarake Nevzat Haznedari.

Në fq.280 gjendet vendimi i Komisionit Qëndror për Konfiskimin e Pasurive për konfiskimin e pasurisë të Qenan Abdurrahman Dibrës.

Në fq.319 gjendet një listë e personave të arrestuar nga Grupi i Bashkimit Demokrat ku thuhet se: *“Qenan Dibra i Abdurrahmanit nga Dibra, avokat i arrestuar në (10.01.1946) me akuzën: Sabotator i Pushtetit dhe armik i Popullit, pjestar dhe organizues i grupit monarkist kundra Pushtetit në lidhje dhe me grupe të tjerë. Proçeduar.”*⁴

² Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081.A.1, fq.224

³ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081.A.1, fq.277.

⁴ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081.A.1, fq.319.

Në fq.382 të dosjes gjendet një informacion në lidhje me memorandumin që i ishte dorëzuar anglezëve: “Kohët e fundit Englezëve u është dorëzuar një memorandum ku protestohet për njohjen e Qeverisë dhe njohja e Bashkimit Demokratik. Bashkimi Demokratik, doli nga Bashkimi i:

1)Partisë Social-Demokrate

2)Partisë Zogiste,

3)Fronti i Rezistencës (Muharrem Bajraktari, Fiqiri Dinia etj)

Memorandumi është nënshkruar nga 5 vetë, njëri prej të cilëve një far Anton (ish nëpunës në Botore)

Gjergji Kokoshi është në dijeni të memorandumit.

Të Gjithë Punojnë kundra nesh, mund të kenë hedhur këta traktet në Tiranë.

Organizata Monarkiste: Qenan Dibra (i biri i Abdurrahmanit) dhe Xhahit Koka.

Social-Demokratët: Kokalari (vajzë).

Fronti i Rezistencës: Sami Qelibashi.

Këta kanë bërë memorandumin dhe mbledhjen si përfaqësues për Bashkimin Demokratik.”⁵

Në Akt-Akuzën e Gjykatës të Lartë Ushtarake në lidhje me Qenan Dibrën Thuhet se:

“Sikurse do të konstatohet dhe nga process-verbalet e mbajtura prej Seksionit të M.P të Tiranës që bashkangjitur paraqiten i pandehuri Qenan Dibra, i biri i Abdurrahmanit dhe i Adiles, vjeç 34 nga Dibra, me profesion ose efektiv Avokat i rreshtuar më datën 10 Janar 1946, akuzohet se i pandehuri Qenan Dibra ka marrë pjesë në grupin tradhëtar-Monarkist dhe është një ndër organizatorët e këtij Grupi, që ka patur për qëllim të rrëzojë pushtetin e popullit me violence dhe të bjerë edhe një here në fuqi tradhëtarët e Legalitetit dhe rregjimin e terrorit të Zogut..

2) Ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e mshefta që ka bërë Grupi Monarkist si dhe me mbledhjen e të Gjithë Grupeve tradhëtare duke zgjedhur një Komitet të përbashkët ku i pandehuri u bë anëtar i këtij Komiteti.

Me veprimtarinë e tij është munduar të sabotojë zgjedhjet që do të bënte populli shqiptar në 2 Dhjetorit në lidhje me kriminelët dhe me reaksionin.”⁶

Në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij dhe të tjerëve ai u mbrojt nga avokat Arsitidh Totozani, edhe ky i dënuar në proçese të mëvonshme.


Terenc Toci dhe “administrata e shtetit para gjyqit.”

Në fundin e vitit 1944 për të intesifikuar veprimet e tyre repressive udhëheqja komuniste shqiptare formoi me urgjencë “Komisionin Qëndror për Krimet dhe Kriminelët e Luftës”. Që

⁵ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081.A.1, fq.382.

⁶ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr.1 Hetimore-Gjyqësore, Dosje 1081.A.2, fq.178.

në vitin e parë të rregjimit komunist, pati shumë të dënuar me vdekje dhe burgim të përjetshëm, ndërsa numri i të dënuarve me burg e punë të detyruar ishte akoma më i madh. Një prej proceseve, i cili i përket këtij serie gjyqesh ishte edhe Gjyqi Special për Kriminelët e Luftës dhe Armiqtë e Popullit i njohur ndryshe si *Gjyqi Special* ishte një gjykatë komuniste që veprroi në pranverën e 1945 (1 Mars - 1 Prill). Një prej personave të dënuar nga ky proces gjyqësor ishte edhe avokati Terenc Toçi.



Terenc Toçi



Emër/Mbiemër	Terenc Toçi
Atësia	Paolo
Vendbanimi	Tiranë
Datëlindja	9 Mars 1880
Profesioni/Edukimi	Jurist, Avokat, Nëpunës, Botues/Universiteti i Drejtësisë, Urbino, Itali
Dita e vdekjes	15.04.1945
Dita e Arrestimit	
Akuza	Kriminel Luftë.
Lloji i ekzekutimit	Me pushkatim
Fondi arkivor	Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 1 Hetimor – Gjyqësor, Dosje nr. 1568.
Tipologjia e Dokumentit Arkivor	Hetimore-Gjyqësore

Terenc Toçi ishte një jurist, publicist, politikan dhe veprimtar i njohur arbëresh, i cili dha një kontribut të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare shqiptare gjatë fillimit të shekullit XX. Ai lindi më 9 Mars 1880 në San Cosmo Albanese të Kalabrisë, Itali, dhe u arsimua për drejtësi. I frymëzuar nga idealet kombëtare, u angazhua për çështjen shqiptare dhe në vitin 1911 organizoi një kuvend në Orosh të Mirditës, ku u ngrit flamuri kombëtar dhe u shpall simbolikisht pavarësia e Shqipërisë. Përveç veprimtarisë politike, Toçi kontribuo edhe në fushën e gazetarisë dhe publicistikës, duke botuar gazeta e revista që promovonin kulturën dhe identitetin kombëtar shqiptar. Më vonë ai mbajti poste të rëndësishme në administratën shtetërore shqiptare. Megjithatë, përfshirja e tij në administratën e periudhës së pushtimit italian e bëri figurën e tij objekt debatesh historike. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ai u arrestua nga regjimi komunist, u dënua si bashkëpunëtor i pushtuesit dhe u ekzekutua në vitin 1945. Sot, Terenc Toçi kujtohet si një figurë me kontribute të rëndësishme për çështjen kombëtare shqiptare, ndonëse roli i tij në disa periudha të jetës vazhdon të vlerësohet në mënyra të ndryshme nga historianët.

Në Akt-Akuzën e Gjyqit Special për Kriminelët e Luftës në lidhje me Terenc Toçin thuhet se:

“Terenc Toçi. Akuzat:

1. *Ka bërë tradhëti të Naltë kundra integritetit toksuer dhe interesave të nalta t’Atdeut pse ka qënë në lidhje me italianët para 7 Prillit 1939 me përgatitjen e okupacionit fashist.*
2. *Ka qënë armik i popullit, si Kryetar i Dhomës Koorporative fashiste, ka future popullin shqiptar në luftë kundra popujve fqinjë dhe aleatëve të mëdhenj demokratikë.*
3. *Ka tradhëtuar interesat vitale ekonomike të popullit tue përkrahur dhe aprovar dhenien e konçesioneve të ndryshme shoqërive tragtare italiane.*
4. *Asht përgjegjës për proglumimin e ligjeve të ndryshme t’okupacionit Fashist për të shtypur popullin dhe për të pakësuar rezistencën e tij passive dhe active kundra okupatorit*
5. *Si publicist dhe propagandist asht bërë vegël e propagandës armike.*
6. *Me raporte të drejtuara Luogotenencës dhe autoriteteve të tjera t’okupacionit ka dhënë informata rreth gjëndjes shpirtnore të popullit Shqiptar që sabotonte veprën e fashizmit në Shqipëri, tue i këshillue fashistët si me veprue për të pasur më shumë sukses në punën e tyre, cilëson okupacionin fashist si kryengritje nationale dhe me fjalimet që ka mbajtur në Milano në 20 Prill 1942 flet për një “Benessere nel ombra del Tricolore” duke eksaltue idenë imperiale fashiste.*
7. *Tue qënë në marrëveshje me armikun ka sabotue luftën e popullit prej dates 8 Prill 1939 deri në kapitullimin e Italisë.”⁷*

Në fq.99-129 gjendet pretenca e Prokurorit të Gjyqit Special e përgatitur në 4.4.1945. Në fq.130-136 gjendet vendimi i Gjykatës Speciale për Kriminelët e Luftës i dt.13 Prill 1945 që e dënonte Terenc Toçin me vdekje si Kriminel Luftë.

Në fq.144 gjendet dhe kush e kishte luajtur rolin e mbrojtjes në këtë Gjyq. Ata janë avokatët : Kristo Celi, Kristaq Nico, Myzafer Pipa, Ilia Cipi, Haki Karapici, Sprio Stringa, Suat Asllani Vasil Bidoci, Aristidh Totozani etj.

⁷ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 1 Hetimor – Gjyqësor, Dosje nr. 1568, fq.57.



Në fq.154 gjendet procesi gjyqësor që ka nisur në 1 Mars 1945. Mbrojtjen e Terenc Toçi do ta kryente Av.Kristaq Niço.⁸

Në fq.167-172 gjendet procesi ndaj Terenc Toçit.

Në fq.578 gjendet një deklaratë e bërë prej Terenc Toçit: *“Terenc Toçi tha se bashkohem me mbrojtësin dhe paraqiti një mbrojtje personale të përbanun prej 11 faqesh daktilografike si dhe dy libra : “Shqiponja Arbënore” dhe “E drejta ndëshkimore”, duke thënë se unë gjithnjë kamë qënë në favour të djelmënis Shqiptare dhe librin “Shqiponja Arbënore” e kanë botuar në Korrik 1943. Duhet të kihet parasysh se unë qysh prej kohësh që jam larguar nga shërbimi e gjatë gjithë kohës së okupacionit gjerman kam qëndruar krejt i izoluar në shtëpinë time pa u përzi me politikë. Prandaj kam bindjen se Gjykata e Popullit ka me më gjykue me klemencën më të madhe.”*⁹

Mbi Gjyqin Special

Në Nëntorin e 1944 partizanët komunistë morën pushtetin dhe menjëherë nisën arrestimet dhe pushkatimet e figurave publike që perceptoheshin sikur kishin bashkëpunuar me

⁸ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 1 Hetimor – Gjyqësor, Dosje nr. 1568, fq.155.

⁹ Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 1 Hetimor – Gjyqësor, Dosje nr. 1568, fq.578.

pushtuesin ose që nuk kishin ndihmuar Lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Gazeta "Bashkimi", organi i shtypit i Frontit Demokratik i Shqipërisë, në janar të 1945 hapej me editorial "Trathëtorët" me ton nxitës dhe gjuhë të ashpër kundrejt "tradhëtarëve" dhe "armiqve të popullit".

Gjyqi Special u çua në këmbë nga regjimi komunist i porsaardhur në fuqi kundrejt të etiketuarve "armiqtë e popullit" dhe "kriminelët e luftës". U themelua në bazë të vendimit të marrë nga Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar më 15 dhjetor 1944, u formua me vendimin nr. 2 të Këshillit të Ministrave. Si në pjesën tjetër tjetër të Evropës Lindore, spastrimi i të ashtuquajturve "fashistë" dhe "kriminelë lufte" luajti një rol qendror në themelimin dhe ndërtimin e një rendi mbështetur tek modeli sovietik.

Në kohën që u krijua Gjykata Speciale, Shqipëria komuniste nuk kishte ligj për krimet e luftës, por, sipas vendimit 26, "kriteret mbi kriminelët e luftës, dënimi i tyre dhe procedura të bëhen në bazë të rregullores mbi gjyqet ushtarake." Ligji nuk e përcakton cila ishte kjo rregullore: me datë, numër dhe organin që e kishte miratuar.


Këto rregullore, ose ajo që përmendet në vendim, kanë rëndësi vetëm për faktin se, duke këqyrur dokumentet e Gjyqit, zbulojmë që baza ligjore nuk është "rregullorja" e përmendur në vendim, por "Ligji mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake", nr. 41, i botuar në Fletoren Zyrtare, më 23 Janar 1945.

Megjithatë, Gjykata Speciale nuk i qëndroi besnike as detyrës që i ngarkonte Vendimi nr. 26 për krijimin e saj dhe as Ligjit nr. 41.

Gjykata Speciale gjykoi 60 persona. Nga ata, 24 u dënuan si kriminelë lufte, 17 me vdekje dhe 7 me burgime të ndryshme. Gjithë të pandehurit e tjerë u dënuan për akuzën "armik i popullit", e cila nuk ishte në juridiksionin e Gjykatës Speciale. Detyra e saj ishte e përcaktuar qartë: të gjykonte kriminelët kryesorë të luftës, shqiptarë ose të huaj. Ata që konsideroheshin "armiq të popullit", mund të ishin gjykuar nga një gjykatë tjetër.

Në Aktakuzë, Prokurori u shpreh se krimet për të cilat akuzoheshin të pandehurit parashikoheshin në nenin 14 dhe 15 të Ligjit nr. 41. Gjykata Speciale, nëse do të ishte e interesuar për zbatimin e ligjit dhe dhënien e drejtësisë, nuk duhet t'i konsideronte për gjykim akuzat bazuar në nenin 15, sepse ai nen përfaqësonte kriminelët e quajtur "armiq të popullit"

Baltazar Benusi.



Emër/Mbiemër	Baltazar Benusi
Atësia	Gaspër
Vendbanimi	Shkodër
Datëlindja	6 Janar 1897
Profesioni/Edukimi	Jurist, Avokat, Nëpunës/Universiteti i Drejtësisë, Romë, Itali. Me gradë Doktor Shkencash
Dita e vdekjes	1982
Dita e Arrestimit	17 Maj 1947
Akuza	<i>"Propagandë dhe si pjesëmarrës në organizatën «Bashkimi Demokrat, ka hapur parulla me qëllim që të ulin prestigjin e Shtetit"</i>
Masa e dënimit	Me 15 vjet Burg, pas faljes me 7 vjet.
Fondi arkivor	Arkiva e Autoritetit, Fondi nr. 1 Hetimor – Gjyqësor, Dosje nr. 1314.
Tipologjia e Dokumentit Arkivor	Hetimore-Gjyqësore

Jurist, një nga hartuesit e legjislacionit shqiptar të periudhës së Monarkisë, avokat. Lindi më 6 Janar të vitit 1897, në qytetin e Shkodrës. Filloi mësimet në Kolegjin Saverian të qytetit, por i ndërpreu ato për t'i vazhduar katër vitet e fundit në Kolegjin Jezuit të Peshtit në Hungari. Pas mbarimit të shkollës, më 1916 u kthye në vendlindje. Më 1920 iu aprovua e drejta për të ndjekur studimet në degën e Jurisprudencës pranë Universitetit të Romës në Itali.

U diplomua në vitin 1924. Më vonë mbrojt dhe gradën shkencore Doktor në Jurisprudencë. Është një nga hartuesit e Legjislacionit modern shqiptar të periudhës së Monarkisë shqiptare. Pas mbarimit të Luftës punoi si avokat. Në vitin 1947 u arrestua në qytetin e Beratit, i akuzuar për agjitacion e propagandë dhe si pjesëmarrës në organizatën «Bashkimi Demokrat». Më 30 Mars 1948, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor se ka «marrë pjesë në mbledhje të ndryshme, dhe ka hapur parulla me qëllim që të ulin prestigjin e Shtetit dhe të ngjallin pabesim ndaj masës së popullit» dhe e dënnoi me 15 vjet heqje lirie, humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet kohë, si dhe me konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Por një muaj më vonë, më 21 prill të po atij viti, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake ia ktheu dënimin në 5 vjet privim lirie dhe konfiskim të gjysmës së pasurisë. Kështu, më 20 gusht të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Në lidhje me dosjen hetimore-gjyqësore ndaj Baltazar Benusit dhe të tjerëve.

Në dt.30.3.1948 në Gjykatën Ushtarake të Garnizonit të Tiranës u zhvillua gjyqi ndaj Baltazar Benusit dhe disa personave të tjerë me akuza të ndryshme.

Në fq.10 ndodhet një informacion mbi Baltazar Benusin: *“Baltazar Benusi, i biri i Gjergjit dhe i Ciciles, vjeç 51, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, i martuar me 4 fëmijë, i pa dënuar, me profesion avokat, me gjendje ekonomike të mesme, me shtetësi shqiptare, gjatë kohës së okupacionit nuk ka marrë pjesë as me ballin as me legalitetin, nuk ka ndonjë farefis të arratisur, as të dënuar, i arrestuar në datën 17 Maj 1947.”*

Akuza që do ti drejtohej Baltazar Benusit gjendet në fq.11: *“Baltazar Benusi qysh në kohën e rregjimit zogolljan ka qënë spiun i gjermanëve dhe i englezëve, të cilë ju ka dhënë informata për në dëm të atdheut. Porsa u çlirua Shqipëria fillon aktivitetin e tij kundështar me Gjergj Kokoshin, Suat Asllanin etj., e më vonë mbasi këta arrestohen ja fillon rishtaz veprimtarisë në lidhje me Shefqet Bejën etj., për rrëzimin e pushtetit popullor me violence. Ka pasur lidhje të ngushta me anëtarët e misionit Anglo-Amerikan të cilëve ju ka dhënë informata me karakter politik, ekonomik dhe ushtarak dhe ka kërkuar prej tyre një ndërhyrje ushtarake për rrëzimin e Pushtetit. Ka pasur lidhje të vazhdueshme me kryeagjentin e UNRAS Halle Halldin e më vonë me Flladin të cilëve ju ka dhënë informata me sekret shtetëror. Ka qënë një nga krerët e organizatës së deputetëve.”*

Në fq.15 gjendet vendimi i Gjykatës që e dënonte me 15 vjet privim lirie.

Në fq.16 gjendet vendimi i dt.11.12.1948 për uljen e dënimit me 7 vjet privim lirie dhe gjysmën e konfiskimit të pasurisë.

Në fq.17-20 gjendet procesverbali i dhënë prej Baltazar Benusit. Në fq.31 gjendet vendimi i Gjykatës së Lartë Ushtarake që flet për uljen e dënimit të Baltazar Benusit. Në fq.112 gjendet akt-akuza ndaj Baltazar Benusit. Në fq.113-119 gjendet procesverbali i Baltazar Benusit. Në fq.120 gjendet urdhëresë e paraburgimit. Në fq.167 gjendet një letër që Baltazar Benusi i dërgon Gjykatës së lartë Ushtarake me anë të të cilës kërkon uljen e dënimit të tij.

Përfundime

Procesi i konsolidimit të pushtetit komunist në Shqipëri gjatë viteve të para të regjimit, 1944–1948, u shoqërua me një sërë procesesh gjyqësore, në të cilat u përfshinë dhe u dënuan një numër avokatësh të arsimuar në Perëndim. Kjo kategori e elitës intelektuale, përmes

qëndrimeve dhe veprimtarisë së saj konkrete, dëshmoi një qëndresë ndaj instalimit të dhunës politike dhe kufizimit të lirive. Goditja ndaj këtyre individëve nuk ishte e rastësishme, por pjesë e një politike të qëllimshme të regjimit për eliminimin e çdo hapësire të mundshme të autonomisë intelektuale dhe profesionale. Në këtë kuadër, goditja e avokatëve të arsimuar në Perëndim synonte jo vetëm dobësimin e kësaj shtrese intelektuale, por edhe nënshtrimin e institucionit dhe profesionit të avokatisë ndaj strukturave të reja të pushtetit, në funksion të konsolidimit të regjimit komunist dhe të “diktaturës së proletariatit”.